

mund të mbrohen nga hepatiti B nëse mjekohen shpejt. Duhet ta sillni fëmijën te mjeku juaj ose në urgjencë dhe të tregoni se ka qenë në kontakt me hepatitin B. Ata do të përgatitin një injeksion të imunoglobulinës së hepatitit B (HBIG) dhe do të fillojnë me procesin e vaksinimit kundër hepatitit B.

- Mos përdorni të njëjtat furçe dhëmbësh, brisqe, gjilpëra, limë, prerëse dhe gërshërë thonjsh, peshqirë me dikë që ka hepatit B.

## Ju nuk mund ta përhapni hepatitin B nga:

- Teshtima ose kolla
- Puthjet ose përqaqimet
- Të ushqyerit me gji
- Ushqimi ose uji
- Përdorimi i enëve dhe gotave të njëjta
- Kontakte të rastësishme (si në punë)

Ju nuk duhet të përjashtoheni nga kujdesi për fëmijën, nga shkolla, puna ose aktivitete të tjera, vetëm se jeni me hepatit B.

## Mos harroni:

Sigurohuni që foshnja juaj të vaksinohet plotësisht kundër hepatitit B në kohën e duhur, në mënyrë që të jetë e mbrojtur.

## Si mund të informohem më shumë?

Informacione të nevojshme për hepatitin B mund të merrni nga:

- Mjeku juaj i familjes
- Zyra lokale e shëndetit publik të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore (HSE)

Mund të gjeni broshura të tjera mbi hepatitin B në faqet e mëposhtme të internetit:

- [www.hpsc.ie](http://www.hpsc.ie)
- [www.cdc.gov/hepatitis/hbv](http://www.cdc.gov/hepatitis/hbv)
- [www.who.int](http://www.who.int)
- [www.immunisation.ie](http://www.immunisation.ie)



Data e publikimi: Prill 2017

Autorët: Grupi i punës për sëmundjen e hepatitit të Grupit të sëmundjeve transmetuese të mjekësisë publike, Departamenti i Shëndetit Publik dhe Qendra e Mbikëqyrjes së Mbrojtjes së Shëndetit, Drejtorja e Shërbimeve Shëndetësore.



# Hepatitis B

Ju dhe foshnja juaj



Nëse jeni me hepatit B dhe shtatzënë, planifikoni të mbeteni shtatzënë, nëse sapo keni sjellë në jetë një foshnjë ose keni fëmijë, kjo fletushkë informacioni ju tregon se si të mbron foshnjën dhe fëmijët tuaj.

Vaksinimi është shumë i efektshëm në parandalimin e infeksionit të hepatitit B tek foshnjat dhe fëmijët.

## Çfarë është hepatiti B?

Hepatiti B është një virus që prek mëlçinë, nga i cili mund të sëmureni rëndë. Ai përhapet nëpërmjet kontaktit me gjakun ose lëngjet trupore të një personi të infektuar. Disa njerëz me hepatitin B nuk e eliminojnë kurrë virusin dhe mund të mbeten të infektuar për gjithë jetën. Ky është infeksion kronik i hepatitit B dhe njerëzit që janë të infektuar mund të infektojnë të tjerët. Disa njerëz me infeksion kronik të hepatitit B zhvillojnë më tej sëmundje të rëndë të mëlçisë. Disa njerëz me infeksion kronik të hepatitit B nuk shfaqin simptoma dhe mund ta përhapin virusin te të tjerët pa e ditur.

## Po nëse jam shtatzënë?

Gratë shtatzëne duhet të testohen për hepatit B. Nëse rezultoni pozitiv, mjeku obstetër ose ai i familjes mund t'ju referojë te një specialist.

## Çfarë rreziku përbën kjo për foshnjën time?

Ju mund të infektoni foshnjën tuaj me hepatitin B gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes, përveçse kur foshnja është vaksinuar.

Fëmijët që infektohen me hepatitin B në fillim të jetës së tyre, janë më të rrezikuar ndaj infeksionit kronik. Deri

në 90% e foshnjave të infektuara në lindje preken nga infeksioni kronik nëse nuk vaksinohen. Kjo shpesh sjell probleme shëndetësore më vonë në jetë.

## Si mund ta mbroj foshnjën time?

Mënyra më e mirë për të mbrojtur foshnjën tuaj të porsalindur nga hepatiti B është vaksinimi. Vaksinimi përbëhet nga një vaksinë e hepatitit B me imunoglobulinë të hepatitit B (HBIG).

- Doza e parë e vaksinës së hepatitit B dhe një dozë e imunoglobulinës së hepatitit B (HBIG) duhet t'i jepen foshnjës suaj menjëherë pas lindjes.
- Sigurohuni që foshnja juaj të marrë dozat e ardhshme të vaksinës, zakonisht kur është dy, katër dhe gjashtë muajsh, si pjesë e planifikimit të rregullt të vaksinimit të fëmijëve.
- Mjeku juaj i familjes ose pediatri do të bëjë një analizë gjaku dy muaj pas përfundimit të vaksinimit për të kontrolluar nëse foshnja juaj është e infektuar apo jo. Nëse foshnja juaj nuk është e infektuar, analiza e gjakut shërben për të treguar se fëmija juaj është i mbrojtur nga vakcina.
- Mbi 95% e foshnjave që marrin vaksinën e plotë kundër hepatitit B dhe imunoglobulinën e hepatitit B janë të mbrojtur nga ky hepatit.

Sigurohuni që foshnja juaj të vaksinohet plotësisht kundër hepatitit B në kohën e duhur, në mënyrë që të jetë e mbrojtur.

## A është e sigurt vakcina kundër hepatitit B?

- Vakcina kundër hepatitit B është e sigurt dhe e efektshme.
- Efektet anësore mund të përfshijnë dhimbje dhe skuqje në zonën e shpimit.
- Vakcina kundër hepatitit B mund të jepet në të njëjtën kohë me vaksinat e tjera për fëmijët.
- Vakcina kundër hepatitit B nuk përmban produkt gjaku.
- Ju nuk mund të infektoheni me hepatit B nga vakcina.

## Çfarë është imunoglobulina e hepatitit B?

- Imunoglobulina e hepatitit B (HBIG) mund të ofrojë mbrojtje të hershme për ata me rrezik të lartë të infeksionit, siç janë foshnjat e porsalindura të nënave të infektuara.
- Kjo përmban produkt gjaku. Dhuruesit e gjakut kontrollohen me kujdes. Gjaku analizohet dhe trajtohet për të zvogëluar rrezikun e infeksionit.
- Ajo nuk përbën pengesë për vaksinat e tjera që i jepen foshnjës.

Lindja me operacion nuk e mbron fëmijën tuaj nga hepatiti B.

Ushqyerja me gji është e sigurt për foshnjën tuaj. Hepatiti B nuk përhapet nga qumështi i gjirit.

## Si mund të mbroj fëmijët e mi të tjerë?

Fëmijët që jetojnë në të njëjtën shtëpi bashkë me ata me infeksion kronik të hepatitit B mund të infektohen.

Hepatiti B mund të përhapet nga një fëmijë ose i rritur i infektuar te fëmijët tuaj të tjerë nëse ata nuk janë vaksinuar. Vaksinoni fëmijët tuaj të tjerë që të mbrohen nga infeksioni. Nëse ju ose dikush në shtëpinë tuaj është me hepatit B, sillni fëmijët tuaj te mjeku i familjes për t'i vaksinuar.

- Vakcina e hepatitit B është një vaksinë e sigurt, e efektshme dhe mbrojtja juaj më e mirë. Vakcina jepet gjatë një faze prej tre injeksionesh. Pas tre injeksionesh, mund të bëhet analiza e gjakut për të parë nëse tani jeni të mbrojtur. Efektet anësore mund të përfshijnë dhimbje krahu dhe skuqje në pjesën ku është bërë injeksioni.
- Nëse jeni shtatzënë ose dëshironi të mbeteni shtatzënë, është mirë ta diskutoni këtë me mjekun tuaj përpara se të vaksinoheni.
- Mos i lejoni fëmijët që të prekin gjak ose lëngje trupore, ose inde të ndotura me këto, të personit që është infektuar me hepatit B.
- Nëse fëmijët janë të ekspozuar ndaj gjakut të personit të infektuar me hepatit B dhe nuk janë mbrojtur nga infeksioni nëpërmjet vaksinimit, ata